

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME "MEDIA +" sh.a.

Neni 1. Themeluesit

Ortakët themelues:

1. Gëzim Ismaili, I biri I Ahmetit dhe I Hatixhes, I datëlindjes 1952, lindur në Durrës dhe banues në Shijak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Ramazan Ismaili, I biri I Ahmetit dhe I Hatixhes, I datëlindjes 1954, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
3. Fatbardh Merko, I biri I Shefqetit dhe I Dritës, I datëlindjes 1969, lindur në Tiranë dhe banues në Shijak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
4. Muhamer Çipi, I biri I Ramadanit dhe I Shqipëries, I datëlindjes 1964, lindur në Ersekë dhe banues në Shijak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

bien dakord për themelimin e shoqërisë anonime "MEDIA +" sh.a.


Neni 2. Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë veprimtarinë radiotelevizive në kuptimin e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe përgjithësisht çdo operacion financiar tregtar, industrial, me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme që mund të lidhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me ushtrimin e veprimtarisë radiotelevizive.

Neni 3. Selia, vula

Selia e shoqërisë vendoset në adresën: Rruga e Kavajës, sheshi "Ataturk", Tiranë.

Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda rrethit Tiranë ose në një rreth tjetër me një vendim të thjeshtë të këshillit mbikqyrës, vendim ky që i njoftohet asamblesë së përgjithshme të zakonshme më e afërt.





Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve.

Në rastin e një transferimi me vendim të këshillit mbikqyrës ky i fundit është i autorizuar të bëjë ndryshimin e duhur në statut.

Vula e shoqërisë do të përmbajë emërtimin e shoqërisë, të ndjekur nga shkurtimi "sh.a.", si dhe adresën e selisë së saj.

Neni 4. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar 30 vjet duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Shkurtimi i kësaj kohëzgjatje në rastin e një prishje të përsheptuar ose zgjatja e afatit bëhen me vendim të asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionerëve.

Neni 5. Kontributet

Kapitali themeltar i shoqërisë do të përbëhet nga kontribute në para.

Ortakët themelues bien dakord që kapitali i shoqërisë të ndahet midis ortakëve si më poshtë:

1. GEZIM ISMAILI	:	40% e aksioneve;
2. RAMAZAN ISMAILI	:	35% e aksioneve;
3. FATBARDH MERKO	:	15% e aksioneve;
4. MUHAMER ÇIPI	:	10% e aksioneve;

Aksionet për kontributin në para do të shlyhen plotësisht në momentin e nëshkrimit të tyre.

Derdhjet e kontributit në para do të depozitohen pranë _____, që do të funksionojë si mbajtës i fondeve, i cili mbi bazën e listës së aksionerëve, do të evidencojë në një certifikatë të posaçme shumat e derdhura nga sejcili prej tyre.

Neni 6. Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar caktohet në statutin e shoqërisë, në vijim të kontributit të ortakëve themelues dhe në përputhje me përqindjet e rëna dakord në këtë akt themelimi.

Ai do të ndahet në aksione nominale vlera e të cilave gjithashtu do të përcaktohet në statut.



Neni 7. Hyrja në fuqi dhe themelimi i shoqërisë

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Asambleja themeluese e ortakëve të shoqërisë do të mbahet jo më vonë se dy javë nga marrja e certifikatës së mbajtësit të fondeve.

Asambleja themeluese do të miratojë statutin e shoqërisë dhe do të zgjedhë këshillin e parë mbikëqyrës dhe ekspertët e parë kontabël.

Shoqëria themelohet dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar të gjykatës së rrethit Tiranë. Kërkesa për regjistrimin e shoqërisë do të depozitohet në regjistrin tregtar brenda dy javëve nga nënshkrimi i statutit.

Ky akt themelimi i hartuar në katër kopje origjinale, nënshkruhet nga ortakët themelues si vijon:

1. GEZIM ISMAILI

2. RAMAZAN ISMAILI

3. FATBARDH MERKO

4. MUHAMER ÇIPI

STATUT I SHOQERISE ANONIME

"MEDIA +" sh.a.

Neni 1. Forma

Pronarët themelues me aktin e themelimit kanë vendosur krijimin e një shoqërie anonime në kuptimin e nenit 74 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" si shoqëri anonime pa ofertë publike. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas ligjeve në fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2. Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë veprimtarinë radiotelevizive në kuptimin e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe përgjithësisht çdo operacion financiar tregtar, industrial, me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme që mund të lidhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me ushtrimin e veprimtarisë radiotelevizive.

Neni 3. Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është "MEDIA +".

Në të gjitha aktet dhe dokumentet që dalin nga shoqëria emërtimi i saj do të ndiqet nga inicialet "sh.a." dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 4. Vendndodhja e selisë

Selia e shoqërisë përcaktohet në aktin e themelimit të saj.

Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda rrethit Tiranë ose në një rreth tjetër me një vendim të thjeshtë të këshillit mbikqyrës, vendim ky që i njoftohet asamblesë së përgjithshme të zakonshme më e afërt.

Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve.

Në rastin e një transferimi me vendim të këshillit mbikqyrës ky i fundit është i autorizuar të bëjë ndryshimin e duhur në statut.

Neni 5. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar 30 vjet duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Shkurtimi i kësaj kohëzgjatje në rastin e një prishje të përshpejtuar ose zgjatja e afatit bëhen me vendim të asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionerëve.



Neni 6. Kontributet

Në momentin e themelimit, shoqërisë I janë sjellë si kontribut për një shumë prej 2 milion lekë, që I korrespondojnë vlerës nominale të aksioneve nr.001 deri në nr. 200, të gjitha në para, aksione këto të nënshkuara dhe të shlyera tërësisht nga:

1. Gëzim Ismaili, I biri I Ahmetit dhe I Hatixhes, I datëlindjes 1952, lindur në Durrës dhe banues në Shijak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar:
në shumën 800000 lekë, për aksionet nr. 001deri 080;
2. Ramazan Ismaili, I biri I Ahmetit dhe I Hatixhes, I datëlindjes 1954, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar:
në shumën 700000 lekë, për aksionet nr. 081deri 150;
3. Fatbardh Merko, I biri I Shefqetit dhe I Dritës, I datëlindjes 1969, lindur në Tiranë dhe banues në Shijak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar:
në shumën 300000 lekë, për aksionet nr. 151 deri 180;
4. Muhamer Çipi, I biri I Ramadanit dhe I Shqipëries, I datëlindjes 1964, lindur në Ersekë dhe banues në Shijak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar:
në shumën 200000 lekë, për aksionet nr. 181deri 200;

Shuma totale e derdhur nga aksionerët ka qenë depozituar në llogari të shoqërisë në _____ dhe derdhjet e nënshkruesve janë vërtetuar në një certifikatë të hartuar në pajtim me ligjin dhe lëshuar nga _____.

Tërësia e kontributeve të treguar më sipër përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7. Kapitali Themeltar


Kapitali themeltar është caktuar në 2 milion lekë.
Ai është I ndarë në aksione me vlerë nominale 10000 lekë sejcili.

Neni 8. Llogari rrjedhëse

Aksionerët mund ti japin shoqërisë fonde në llogari rrjedhëse. Mënyrat e funksionimit të këtyre llogarive vendosen në çdo rast nga drejtori I drejtorisë dhe të interesuarit.

Neni 9. Zmadhimi I kapitalit themeltar

Kapitali themeltar I shoqërisë mund të zmadhohet sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara në nenet 150 deri 160 të ligjit " Për shoqëritë tregtare".


Zmadhimi I kapitalit themeltar mund të kryhet vetëm me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve, në bazë të raportit të Drejtorisë, I cili përmban treguesit e kërkuar nga ligji.

Aksionerët kanë të drejtën e përparësisë për nënshkrimin e aksioneve të shlyeshme në para që emetohen për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është përpjestimore me shumën e aksioneve të zotëruara nga sejcili aksioner përpara zmadhimit të kapitalit.

Aksionerët mund të heqin dorë vetëm individualisht nga e drejta për nënshkrimin e aksioneve të reja. Ata mundën gjithashtu të kërkojnë nënshkrimin e një numri më të vogël aksionesh nga sa u takon sipas parimit të përpjestueshmërisë, por me kusht që asambleja të ketë vendosur shprehimisht për këtë.

Neni 10. Zvogëlimi I kapitalit themeltar

Me rezervën, kur është rasti, të të drejtave të kreditorëve, asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mund të autorizojë ose të vendosë zvogëlimin e kapitalit për çfarëdo arsye ose me çfarëdo mënyre qoftë, por në asnjë rast zvogëlimi I kapitalit nuk mund të cënojë barazimin ndërmjet aksionerëve.

Në rastin e mosrespektimit të kësaj dispozite çdo I interesuar mund të kërkojë nga Gjykata kompetente prishjen e shoqërisë.

Neni 11. Shlyerja e aksioneve


Aksionet për kapitalin në para të nënshkruara në zbatim të një vendimi për zmadhimin e kapitalit do të shlyhen të paktën për 25 % të vlerës së tyre qysh në momentin e nënshkrimit. Primet e emisionit të aksioneve, kur do të ketë të tillë, do të shlyhen tërësisht në kohën e nënshkrimit të aksioneve.

Pjesa tjetër e vlerës do të shlyhet me një pjesë ose disa kaste në bazë të kërimit për shlyerje nga Drejtoria në një afat prej 3 vjetësh nga dita kur zmadhimi I kapitalit është bërë përfundimtar.

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme që vendos zmadhimin e kapitalit ka të drejtë të marrë një vendim për shlyerjen tërësore të aksioneve qysh në momentin e nënshkrimit ose brenda një afati më të shkurtër nga ai I përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

Kërkimi I fondeve u njoftohet nënshkruesve të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për çdo derdhje, me letër rekomande dhe me kthim përgjigje, drejtuar çdo fitullari të aksioneve.

Çdo vonesë në derdhjen e shumave të kërkuara sjell pagimin e interesave sipas % ligjore duke filluar nga data e kërimit të çdo derdhje pa qenë nevoja për të proceduar në formalitete të tjera të çfarëdoshme dhe pa hequr dorë nga veprimet



e shoqërisë ndaj aksionerit drejtues dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuar nga ligji.

Neni 12. Format e aksioneve dhe libri I aksioneve

Aksionet janë të formës nominale.

Pronësia e aksioneve rezulton nga rregjistrimi I tyre në emër të titullarit ose titullarëve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë ose nga ndërmjetësat financiarë.

Sejcili aksioner ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe të marrë një nxjerrje nga libri I aksionerëve I cili vërtetohet me vulën e shoqërisë.

Sejcili aksioner ka të drejtë të verifikojë në se emri I tij është futur në librin e aksionerëve dhe personi I cili mban librin është I detyruar ti tregojë aksionerit, me kërkesën e këtij të fundit, hyrjen përkatëse në libër.

Neni 13. Shitja dhe transferimi I aksioneve

Përveç rastit të trashëgimisë transferimi I pronësisë mbi aksionet një personi jo aksionar, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të miratohet nga këshilli mbikqyrës në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara nga neni 207 I ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Neni 14. Të drejtat dhe detyrat e lidhura me aksionet


Çdo aksion I jep zotëruesit të tij të drejtën e marrjes së një pjese nga fitimet e shoqërisë në përpjestim me kuotën- pjesë të kapitalit që ai përfaqëson.

Çdo aksion jep, gjithashtu, të drejtën e pjesës në aktivin e mbetur të shoqërisë pas shlyerjes së kreditorëve në rastin e një likuidimi të shoqërisë.

Përveç këtyre çdo aksion I jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote dhe të përfaqësimit në asambljetë e përgjithshme në kushtet e parashikuara nga ligji ose të caktuara në këtë statut.

Aksionerët janë përgjegjës deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë. Çdo kërkim fondesh prej saj është I ndaluar.

Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet ndjekin aksionin në çfarëdo formë që ai të transferohet nga njëra dorë në tjetrën.



Trashëgimtarët, kreditorët, persona që kanë të drejta ose përfaqësues të tjerë të aksionerit, nuk mund të kërkojnë vënien e vulave apo të shenjave të tjera mbi pasuritë e shoqërisë, ndarjen ose shitjen në ankand të një pasurie. Ata nuk mund të përzihen në aktet e administrimit të shoqërisë dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre duhet të mbështeten në llogaritë e shoqërisë dhe në vendimet e asamblesë së përgjithshme.

Neni 15. Pandashmëria e aksioneve

Aksionet janë të pandashme përkundrejt shoqërisë.

Bashkëpronarët e aksioneve janë të detyruar të paraqiten pranë shoqërisë nga njëri prej tyre, i konsideruar si pronar i vetëm, ose një përfaqësues i vetëm izgjedhur nga bashkëpronarët. Në rast mosmarrëveshje përfaqësuesi mund të caktohet nga gjykata me kërkesën e bashkëpronarit që e merr i pari këtë nismë.

Neni 16. Drejtoria. Përbërja dhe emërimi.

Drejtimi i përgjithshëm i shoqërisë kryhet nga Drejtori i saj.

Drejtori emërohet nga Këshilli Mbikqyrës. Ai mund të mos jetë aksioner në shoqëri. Drejtori nuk mund të bëjë pjesë në këshillin mbikqyrës të shoqërisë.

Drejtori i ushtron funksionet nën kontrollin e Këshillit Mbikqyrës.

Neni 17. Kohëzgjatja e funksioneve të drejtorit

Drejtoria emërohet pa afat. Ai mund të shkarkohet nga Asambleja e përgjithshme me propozim të këshillit mbikqyrës.

Neni 18. Përfaqësimi te të tretët

Në marrëdhënie me të tretët shoqëria përfaqësohet nga drejtori.

Neni 19. Kompetencat e drejtorit

Drejtori ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, por kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua ka dhënë shprehimisht këshillit mbikqyrës dhe asamblesë së aksionerëve.

Drejtori i ushtron kompetencat e veta brenda objektit të shoqërisë.

Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur këto akte nuk kanë të bëjnë me objektin e shoqërisë

përveç kur provon se të tretët e dinin apo nuk mund të mos e dinin se këto akte ishin jashtë objektit të shoqërisë.

Kur një operacion kërkon autorizimin e këshillit mbikqyrës dhe ky i fundit e refuzon këtë, drejtori mund të thërresë asamblenë e përgjithshme dhe i parashtron asaj çështjen. Asambleja e përgjithshme vendos për kryerjen ose jo të operacionit.

Neni 20. Shpërblimi I drejtorit

Mënyra dhe shuma e shpërblimit të drejtorit caktohet nga Këshilli Mbikqyrës në aktin e emërimit.

Neni 21. Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 9 anëtarë.

Dy të tretat e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës emërohen nga mbledhja e zakonshme e asamblesë, kurse një e treta zgjidhet nga të punësuarit në shoqëri.

Anëtari I Këshillit Mbikqyrës I emëruar nga asambleja nuk mund të jetë I punësuar në shoqëri.

Neni 22. Personi juridik anëtar I Këshillit Mbikqyrës

Një person juridik që është aksioner I shoqërisë mund të jetë anëtar I këshillit mbikqyrës. Në këtë rast ky duhet të caktojë qysh në çastin e zgjedhjes një përfaqësues të përhershëm që do të jetë person fizik, I cili u nënshtrohet të njëjtave kushteve dhe detyrimeve dhe ka të njëjtat përgjegjësi civile dhe penale sikur të ishte ai vetë anëtar I këshillit, duke mos përjashtuar nga përgjegjësia e përbashkët personin juridik që ai përfaqëson.

Në qoftë se personi juridik ja heq mandatin përfaqësuesit të tij duhet të njoftojë për këtë shoqërinë pa vonesë dhe të bëjë njëkohësisht zëvendësimin e tij. Ky rregull do të zbatohet edhe në rastet e vdekjes, të dorëheqjes ose të pengimeve të zgjatura të përfaqësuesit të përhershëm.

Neni 23. Kohëzgjatja e funksioneve dhe vendet bosh në Këshillin Mbikqyrës

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 6 vjet. Çdo vit shtrihet në periudhën e kohës midis dy mbledhjeve të njëpasnjëshme të asamblesë së përgjithshme vjetore.

Në qoftë se një ose disa vende të anëtarëve të këshillit Mbikqyrës të zgjedhur nga asambleja mbeten bosh për shkak të vdekjes, dorëheqjes ose një pengimi

për një kohë të gjatë, ky këshill mbetet në periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërimet të përkohshme.

Emërimet e përkohshme të bëra nga këshilli mbikqyrës I prezantohen për miratim asamblesë së përgjithshme në mbledhjen e saj më të afërt. Në rastin kur asambleja nuk miraton emërimet e përkohshme, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra nga këshilli mbikqyrës mbeten të vlefshme.

Në qoftë se numri I anëtarëve të këshillit mbikqyrës bëhet me më pak se tre drejtoria duhet të thërrasë urgjentisht asamblenë e përgjithshme të zakonshme për të plotësuar efektivin e këshillit.

Anëtari I këshillit mbikqyrës I emëruar në zëvendësim të një tjetri qëndron në funksion deri me përfundimin e mandatit të paraardhësit.

Neni 24. Kryetari dhe zëvendës-kryetari I Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës zgjedh nga gjiri I tij një kryetar dhe një zëvendës-kryetar që ngarkohen me mbledhjen e këshillit dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij. Kryetar dhe zëvendës- kryetari I këshillit mbikqyrës janë detyrimisht persona fizikë dhe nuk mund të zgjidhen ndërmjet përfaqësuesve të personave juridikë. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë periudhës së mandatit në Këshillin Mbikqyrës.

Kryetari dhe Zëvendës-kryetari I këshillit mbikqyrës janë të rizgjedhshëm. Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar të zgjedhur midis anëtarëve të këshillit ose jashtë tyre duke caktuar kohëzgjatjen e funksioneve të këtij.

Neni 25. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës. Quorumi dhe shumica për marrjen e vendimeve.


Këshilli Mbikqyrës mbledhet me thirrjen e kryetarit, ose në rast pengimi të këtij, të zëvendëskryetarit, sa herë që e kërkon interesi I shoqërisë dhe të paktën një herë në tre muaj për të dëgjuar raportin e drejtorisë.

Thirrja e këshillit bëhet me të gjitha mënyrat.

Kryetari I këshillit duhet të thërrasë mbledhjen e këshillit brenda një afai prej 15 ditësh kur të paktën një anëtar I drejtorisë ose një e treta e anëtarëve të këshillit mbikqyrës I paraqesin atij një kërkesë me shkrim të motivuar për këtë. Në qoftë se kërkesës nuk I jepet udhë autorët e saj mund të procedojnë vetë në thirrjen e mbledhjes së këshillit mbikqyrës.

Mbledhjet e këshillit mbikqyrës mbahen në selinë e shoqërisë.

Në thirrje sqarohet rendi I ditës, dita, si dhe ora e mbledhjes.



Çdo anëtar i këshillit mbikqyrës mund ti japë mandat një anëtari tjetër për ta përfaqësuar në një seancë të këshillit. Çdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjtën seancë.

Shqyrtimet dhe vendimet e këshillit mbikqyrës janë të vlefshme kur numri i anëtarëve të pranishëm në mbledhje është të paktën sa gjysma e anëtarëve në funksion.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të përfaqësuar.

Në rast votash të barabarta ajo e kryetarit është përcaktuese.

Në selinë e shoqërisë mbahet një regjistër i pranisë i cili firmoset nga anëtarët e këshillit pjesëmarrës në seancë.

Shqyrtimet dhe vendimet e këshillit mbikqyrës evidencohen me procesverbale të hartuara në një regjistër të posaçëm i numërtuar dhe i vulosur, që mbahet në selitë e shoqërisë, në të cilin tregohen anëtarët e pranishëm të përfaqësuar dhe që mungojnë, si dhe çdo person që ka asistuar në mbledhje tërësisht apo pjesërisht.

Procesverbalet firmosen nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga një anëtar i këshillit.

Neni 26. Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës ushtron kontrollin e përhershëm të drejtimit dhe administrimit të shoqërisë nga ana e drejtorisë.

Ai vendos për operacionet që duhet të kryhen me autorizim të tij në bazë të nenit 21 të këtij statuti.

Këshilli Mbikqyrës miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj, kriteret e punësimit dhe të pagave si dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë.

Në çdo kohë të vitit Këshilli Mbikqyrës kryen të gjitha verifikimet dhe kontrollat që ai çmon të arsyeshme dhe ka të drejtë të kërkojë të njihet me dokumentat që ai gjykon të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tij. Një herë në tre muaj ai merr një raport të paraqitur nga drejtori.

Brenda tre muajve nga mbyllja e çdo viti financiar drejtori i paraqet atij me qëllim verifikimin dhe kontrollin, llogaritë vjetore, si dhe një raport të shkruar për gjendjen e shoqërisë dhe aktivitetet e saj gjatë vitit financiar të mbyllur.

Neni 27. Informimi i anëtarëve të Këshillit



Çdo anëtar i këshillit mbikqyrës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Drejtori informacion për çështje të natyrës administrative, teknike dhe financiare që i mundësojnë atij të verifikojë dhe të gjykojë për kushtet në të cilat zhvillohet veprimtaria e shoqërisë dhe të jetë plotësisht i qartë për vendimet që duhen marrë apo që do të merren nga ana e këshillit.

Kryetari i këshillit ka përgjegjësinë për të vënë anëtarët e këshillit në gjendje që të marrin informacionet e kërkuara.

Çdo anëtar i këshillit duhet të njoftohet personalisht për mbledhjet e këshillit dhe të vihen në dispozicion në selinë e shoqërisë apo ti dërgohen bashkë me thirrjen dokumenta dhe raporte që do të shqyrtohen në mbledhje.

Shoqëria nuk është e detyruar ti japë anëtarëve të këshillit drejtues kopje të procesverbaleve të vendimeve të këshillit, por çdo anëtar mund të kërkojë që të njihet me to në selinë e shoqërisë.

Mosnjohja e të drejtave të çdo anëtari të këshillit për informacionet e mësipërme dhe mosthirrja në mbledhjen e këshillit sjell pavlefshmërinë e vendimeve të këshillit.

Neni 28. Shpërblimi i veçantë për pjesmarrjen në këshill dhe shpërblimet e jashtëzakonshme

Asambleja e përgjithshme e zakonshme mund tu caktojë anëtarëve të këshillit mbikqyrës si shpërblim për pjesmarrjen në këshill një shumë vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri në një vendim të kundërt të asamblesë.


Këshilli mbikqyrës mund të caktojë shpërblime të jashtëzakonshme për anëtarët të cilëve u ngarkohen misione apo u jepen mandate për shpërblime apo detyra të caktuara. Shpërblimet e jashtëzakonshme i nënshtrohen miratimit nga asambleja e përgjithshme e zakonshme sipas rregullave të parashikuara nga nenet 122 deri 126 të ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Shpërblimet e veçanta dhe të jashtëzakonshme përballohen nga llogaria e shoqërisë dhe kalohen në shpenzimet e saj.

Përveç shpërblimeve të përmendura në këtë nen anëtarëve të këshillit nuk u caktohet asnjë shpërblim tjetër i përhershëm ose jo.

Neni 29. Marrëveshjet që kërkojnë autorizim

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe një prej anëtarëve të drejtorisë ose të këshillit mbikqyrës, që lidhet drejtpërdrejtë, apo me të cilin një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt apo nëpërmjet një personi ndërmjetës duhet të autorizohet paraprakisht nga këshilli mbikqyrës.



Kryetari i këshillit mbikqyrës njofton ekspertin kontabël të autorizuar për projekt marrëveshjet që kërkojnë autorizim një muaj përpara se marrëveshja të lidhet dhe ja shtron këto marrëveshje për miratim asamblesë së përgjithshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar I paraqesin Asamblesë një raport të posaçëm për këto marrëveshje, e cila vendos mbi këtë raport.

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për marrëveshjet që kanë të bëjnë me operacionet rrjedhëse dhe të kryera në kushte normale.

Neni 30. Marrëveshjet e ndaluara

Drejtorit dhe anëtarëve të këshillit mbikqyrës, përveç kur këta të fundit janë persona juridikë, u ndalohet të kontraktojnë që të marrin hua nga shoqëria, tu akordohet nga shoqëria një zbulim në llogari rrjedhëse ose në një formë tjetër, si dhe të bëjnë shoqërinë dorëzanëse apo garante për detyrimet e tyre ndaj të tretëve.

I njëjti ndalim zbatohet për përfaqësuesit e përhershëm të personave juridikë anëtarë të këshillit mbikqyrës. Ky ndalim zbatohet, gjithashtu për bashkëshortin, paraardhësit dhe pasardhësit personave të përmendur në këtë nen si dhe për çdo person ndërmjetës.

Neni 31. Detyrimet për ruajtjen e sekretit

Drejtori dhe anëtarët e këshillit mbikqyrës si dhe çdo person tjetër që asiston në mbledhjet e këtyre organeve duhet të ruajnë fshehtësinë për çështjet dhe të dhënat që kanë karakter të brendshëm.


Neni 32. Natyra e asamblesë dhe karakteri detyrues I vendimeve

Asambletë e përgjithshme të aksionerëve cilësohen asamble të zakonshme ose të jashtëzakonshme sipas natyrës së vendimeve që ato janë thirrur për të marrë. Çdo asamble e përgjithshme e mbedhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksionerëve me të drejtë vote.

Vendimet e asamblesë detyrojnë të gjithë aksionerët përfshirë edhe ata që mungojnë në mbledhje apo që votojnë kundër.

Neni 33. Thirrja dhe vendi I asamblesë

Asambletë thirren nga këshilli mbikqyrës ose nga Drejtori. Ato mund të thirren gjithashtu nga eksperti kontabël i autorizuar I pavarur në rast urgjence, nga një mandat mbajtës I caktuar nga Gjykata dhe kur është rasti nga likujduesi.



Asambletë mbledhen në selinë e shoqërisë dhe në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

Thirrja e asamblesë së aksionerëve bëhet me anë të njoftimit që I dërgohet çdo aksioneri në adresën e tij me letër rekomande.

Njoftimi duhet të bjerë në dorën e aksionerëve apo të njihet prej tyre 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë dhe duhet të përmbajë ditën orën, vendin e mbledhjes, natyrën e asamblesë dhe rendin e ditës.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar quorumi I kërkuar mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para, njoftimi ose letrat e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

Neni 34. Rendi I ditës

Rendi I ditës së mbledhjes së asamblesë përcaktohet nga autori I thirrjes. Një ose disa aksionerë që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë kanë të drejtë që të kërkojnë të fusin në rendin e ditës një ose disa projekt-rezoluta.

Këto projekt-rezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me një kërkesë në të cilën tregohen edhe arsyet, si dhe me një dokument që provon zotërimin e pjesës së kapitalit themeltar të kërkuar nga paragrafi I dytë I këtij neni.

Projekt-rezoluta dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 ditë para datës së mbledhjes së asamblesë.

Asambleja e aksionerëve nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje që nuk është përfshirë në rendin e ditës. Megjithatë ajo mundet në çdo rrethanë të shkarkojë një ose disa anëtarë të këshillit mbikqyrës dhe të bëjë zëvendësimin e tyre.

Neni 35. Hyrja në asamble

Çdo aksioner pavarësisht nga numri I aksioneve që zotëron ka të drejtë të asistojë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme dhe të marrë pjesë në vendimet e saj personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve. Hyrja në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme bëhet në bazë të një dokumenti që vërteton identitetin.

Çdo aksioner mund të përfaqësohet në mbledhjet e asamblesë vetëm nga bashkëshorti ose një aksioner tjetër. Për këtë qëllim përfaqësuesi duhet të pajiset nga aksioneri me mandat të posaçëm, në kushtet e parashikuara nga ligji.

Neni 36. Evidenca e pjesmarrjes, drejtimi I mbledhjes dhe proces-verbalet.

Për çdo mbledhje të asamblesë mbahet një fletë pranie e cila përmban treguesit që provojnë identitetin e aksionerit dhe aksionet e zotëruara prej tij. Fletë- prania firmoset në anë nga aksioneri ose, kur është rasti nga përfaqësuesit e tij dhe vërtetohet për saktësinë e saj nga komisioni vëzhgues I mbledhjes.

Mbledhjet e asamblesë drejtohen nga kryetari I këshillit mbikqyrës dhe në mungesë të tij nga zëvendëskryetari ose një anëtar I këshillit I caktuar posaçërisht për këtë qëllim. Në rastet kur thirrja e mbledhjes është bërë nga eksperti kontabël I autorizuar mandat mbajtësi I caktuar nga gjykata apo likujduesi, mbledhja drejtohet nga autori I thirrjes.

Funksionet e vëzhgimit të mbledhjes kryhen nga dy aksionerë të pranishëm të cilët ose si përfaqësues zotërojnë një numër votash më të madh se aksionerët e tjerë. Vëzhguesit caktojnë një sekretar që mund të mos jetë aksioner.

Komisioni I vëzhgimit I formuar në këtë mënyrë, ka për detyrë të verifikojë, të vërtetojë dhe të nënshkruajë fletë- praninë, të mbikqyrë zhvillimin e debateve, të kontrollojë votimet e kryera dhe të sigurojë rregullaritetin e tyre si dhe të mbikqyrë mbajtjen e proces- verbalit të mbledhjes.

Për çdo mbledhje të asamblesë hartohet një proces-verbal I cili përmban:

Datën dhe vendin e mbledhjes

Mënyrën e thirrjes

Rendin e ditës

Drejtuasi I mbledhjes dhe komisioni I vëzhgimit

Numri I aksioneve që marrin pjesë në votim

Quorumi I arritur

Përmendjen e dokumentave dhe të raporteve që janë shtruar në mbledhje.

Një përmbledhje e debateve

Tekstet e projekt-rezolutave të vëna në votim, ato të miratuara dhe ato të hedhura poshtë nga aksionerët


Rezolutat e votimeve

Proces- verbalet e mbledhjes së asamblesë hartohen në regjistër të posaçëm I numërtuar dhe I vulosur, I cili ruhet në selinë e shoqërisë.

Neni 37. Quorumi, votimi, numri I votave

Në asambletë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme, quorumi llogaritet për tërësinë e aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë.

E drejta e votës që u përket aksioneve është në përpjestim me kapitalin që ato përfaqësojnë.



Votimi kryhet me dorën ngritur, me thirrje emërore ose të fshehtë, apo me letër rekomandë, sipas vendimit të komisionit të vëzhgimit dhe drejtuesit të mbledhjes së asamblesë.

Votimi kryhet l veçantë për çdo çështje apo vendim.

Neni 38. Asambletë e zakonshme

Asambleja e zakonshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve të vitit pasardhës, për të vendosur mbi llogaritë e shoqërisë për ushtrimin financiar të mbyllur.

Ajo ka midis të tjerash kompetencat që vijojnë:

Të miratojë strategjinë e zhvillimit afatgjatë të shoqërisë.

Të miratojë plan- biznesin dhe planin financiar vjetor

Të miratojë të ndryshojë ose të hedhë poshtë llogaritë vjetore që janë shtruar për miratim

Të vendosë për shpërndarjen dhe destinimin e rezultatit në pajtim me dispozitat ligjore dhe statutin.

Të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e këshillit mbikqyrës

Të shkarkojë me propozim të këshillit mbikqyrës anëtarët e drejtorisë

Të emërojë ekspertin ose ekspertët kontabël të autorizuar

Të miratojë ose të mos miratojë emërimet e anëtarëve të këshillit mbikqyrës të kryera nga vetë këshilli si emërimet të përkohshme

Të caktojë shpërblimin e veçantë si dhe shpërblime të tjera të parashikuara në këtë statut për këshillin mbikqyrës

Të vendosë për raportin e ekspertit kontabël të autorizuar lidhur me marrëveshjet që l nënshtrohen autorizimit paraprak të këshillit mbikqyrës

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim që nuk sjell ndryshime të statutit.


Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë vetëm kur aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë jo më pak se 50 % të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se asambleja e parë nuk realizohet për mbledhjen e dytë nuk kërkohet asnjë lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 39. Asambleja e jashtëzakonshme

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mbledhet sa herë që duhet të merret një vendim që sjell ndryshime të këtij statuti.

Ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionerëve përveç operacioneve që rrjedhin nga rigrupimi l aksioneve l kryer rregullisht.



Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në mbledhjen e parë vetëm kur aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote.

Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme merren me shumicën prej $\frac{3}{4}$ të votave që u përkasin aksionerëve të pranishëm.

Neni 40. Vënia në dispozicion të aksionerëve e dokumentave dhe informacioneve

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionerëve, në kushtet dhe afatet e parashikuara nga ligji, raportet dokumentat dhe llogaritë vjetore që shqyrton asambleja.

Me përjashtim të inventareve dhe të ndonjë dokumenti tjetër të caktuar nga asambleja, dokumentat që duhet tu vihen në dispozicion aksionerëve u dërgohen këtyre bashkë me njoftim- thirrjet për mbledhje.

Neni 41. Eksperti kontabël i autorizuar. Emërimi dhe shpërblimi

Asambleja e përgjithshme e aksionerëve cakton një kontrollor të pavarur dhe një ndihmës të tij, të zgjedhur të dy nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabël të autorizuar.

Në caktimin e kontrollorëve të pavarur mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara nga ligji "Për shoqëritë tregtare".


Kontrollorët e pavarur caktohen për një kohë që u përgjigjet njëushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm. Shpërblimi i kontrollorëve të pavarur caktohet nga asambleja e aksionerëve dhe përballohet nga shoqëria.

Neni 42. Detyrat dhe të drejtat

Detyrat dhe të drejtat e kontrollorëve të pavarur të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji "Për shoqëritë tregtare".

Asambleja e aksionerëve mund tu kërkojë kontrollorëve të pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje në interes të shoqërisë. Ekspertët kontabël të autorizuar thirren në mbledhjen e drejtorisë që mbyll logaritë e vitit financiar të mbyllur si dhe në të gjitha asambltetë e aksionerëve. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë brenda afateve të parashikuara nga ligji.

Neni 43. Viti financiar



Viti financiar fillon në 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.
Përbashkësisht viti I parë financiar përfshin periudhën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar deri në 31 Dhjetor.

Neni 44. Inventari. Llogaritë vjetore

Shoqëria mban një kontabilitet të rregullt në pajtim me ligjin.

Në mbyllje të çdo viti financiar Drejtoria harton inventarin e elementëve të ndryshëm të aktivitetit dhe të pasivitetit në këtë datë, si dhe llogaritë vjetore të shoqërisë.

Drejtoria harton raportin vjetor për gjëndjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të mbyllur, ndryshimet e ardhshme të parashikueshme, ngjarjet e ndodhura midis datës kur është hartuar raporti dhe veprimet e kërkimit dhe zhvillimit.

Neni 45. Rezultati, caktimi dhe shpërndarja

Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes së amortizimeve dhe të provizioneve. Nga fitimet e ushtrimit pasi të jenë zbritur kur është rasti, humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5 % për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrijn 1/10 e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushtrimit.


Fitimi i shpërndashëm formohet nga fitimi i ushtrimit duke hequr humbjet e mëparshme dhe shumat e hequr për rezervat dhe duke shtuar fitimet e paspërndara të trashëguara.

Megjithatë pas heqjes së shumave për tu kaluar në rezervë në zbatim të ligjit, asambleja e përgjithshme mund të heqë çdo shumë që ajo e gjykon të përshtatshme për të krijuar rezervatë zakonshme ose të jashtëzakonshme ose për të mbartur shumën në ushtrimin e ardhshëm.

Fitimi i shpërndarshëm që mbetet shpërndahet ndërmjet aksionerëve përpjestimisht me numrin e aksioneve që i përkasin secilit.

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë vënien në shpërndarje të shumave që ajo heq nga rezervat që ajo ka në dispozicion. Megjithatë dividendët caktohen në rradhë të parë nga fitimet e shpërndashme të ushtrimit.

Duke përjashtuar rastin kur vendoset zvogëlimi i kapitalit, aksionerëvë nuk mund tu bëhet asnjë shpërndarje në qoftë se si rrjedhojë e shpërndarjes kapitalet e veta të shoqërisë janë ose do të bëheshin me të vogla se shumata e kapitalit të kërkuar nga ligji plus rezervat që nuk mund të shpërndahen.



Në qoftë se eventualisht ndonjë vit financiar mbyllet me humbje, shuma e humbjes pas miratimit të llogarive vjetore nga asambleja, mbartet në ushtrimin vijues, për tu mbuluar nga fitimet e ushtrimeve të ardhshme deri në shuarjen e saj.

Neni 46. Mënyrat e pagimit të dividendëve. Paradhëniet

Asambleja e përgjithshme ka të drejtë ti japë çdo aksioneri për të gjithë ose për një pjesë të dividendëve një opion midis pagimit në para dhe pagimit në aksione. Kërkesa për pagimin e dividendëve me aksione duhet të bëhet në afatin e caktuar nga asambleja, i cili nuk mund të jetë më shumë se tre muaj nga data e vendimit të asamblesë.

Mënyrat e pagimit të dividendëve në para caktohen nga asambleja e përgjithshme, ose në mungesë të saj nga drejtoria. Pagimi i dividendëve në para duhet të kryhet brenda 9 muajve pas mbylljes së vitit financiar, përveç kur ky afat zgjatet me vendim të Gjykatës.

Drejtori mund të vendosë pagimin e dividendëve përpara mbylljes së ushtrimit në formë paradhënie por me respektimin e kërkesave të parashikuara nga ligji.

Neni 47. Zvogëlimi i kapitalit për shkak humbje

Në qoftë se për shkak të humbjeve të pësuarra, të konstatuara në dokumentat kontabël, kapitalet e veta të shoqërisë bëhen më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar drejtoria është e detyruar që brenda 4 muajve nga miratimi i llogarive vjetore ku janë evidentuar këto humbje të thërrisë asamblenë e përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionerëve me qëllim që të vendosë nëse ka vend për prishjen e përshpejtuar të shoqërisë.

Në qoftë se asambleja nuk shpall prishjen e shoqërisë, atëherë në afatin e parashikuar nga ligji dhe me rezervën e nenit 10 të këtij statuti duhet të zvogëlohet në një shumë të barabartë me atë të humbjes së konstatuar në qoftë se në këtë afat kapitalet e veta nuk janë ribërë të paktën të barabartë me gjysmën e kapitalit themeltar.

Në të dy rastet vendimi i asamblesë së përgjithshme publikohet sipas rregullave të kërkuara nga ligji.

Neni 48. Prishja. Likuidimi

Përjashtuar rastin e një prishje me vendim gjyqi të parashikuar nga ligji, shoqëria mund të priset në mbarim të afatit të caktuar në statut ose me vendim të asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme të aksionerëve.

Përveç rastit të bashkimit ose të ndarjes prishja e shoqërisë për çfarëdo shkak qoftë, sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryhet nga një ose disa likuidatorë të

emëruar nga asambleja e përgjithshme e zakonshme ose nga asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme në kushtet e quorumit dhe të shumicës për asambltetë e zakonshme.

Likujdatori përfaqëson shoqërinë. Ai ka kompetenca të plota për të shitur aktivët e shoqërisë, për të shlyer kreditorët dhe për të shpërndarë mbetjen e disponueshme.

Aktivi neto i mbetur, pas shlyerjes së vlerës nominale të aksioneve, ndahet midis aksioneve, ndahet midis aksionerëve në përpjestim me pjesmarrjen e tyre në kapital.

Neni 49. Kundërshtimet


Të gjitha kundërshtimet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj, që lindin midis shoqërisë dhe aksionerëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 50. Anëtarët e parë të këshillit Mbikqyrës

Emërohen si anëtarë të këshillit të parë mbikqyrës për një kohë prej 3 vjetësh.

1. Bardhyl Londo
2. Agim Shehu
3. Agim Faja
4. Ridvan Malltezi
5. Ervin Culi
6. Kreshnik Spahiu

Shënyllat me M.O.
Junta mbikqyrëse




të cilët kanë bërë të ditur që pranojnë funksionet respektive dhe pohojnë se nuk janë të prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tyre.

Neni 51. Ekspertët kontabël të autorizuar

Emërohen si ekspertë Kontabël të Autorizuar për një kohë prej një viti financiar.

Zoti HILL ÇELA





Zoti FETI ZENELI

Të cilët kanë bërë të ditur që pranojnë funksionet e tyre dhe pohojnë se nuk janë të prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tyre.

Gezim Durruti
Durruti

Remuzan Ismaili
Ismaili

Muhamet Lipi
Lipi

Fitbardhë Meke
Meke

Notere Gentiana SHKODRA
Myslym Shyri, P.46, Sh.4, Ap.31
Tel/fax + 355 42 32210
Dhoma e Noterise Tirane
NR 690 REP



VERTETIM NENSHKRIMI


Tirane, me 03/05/2000

Sot me date 03/05/2000 para meje notere Gentiana Shkodra me studio ne qytetin e Tiranës u paraqiten personalisht:

- 1- Muhamer Cipi, I biri I Ramadanit, lindur ne Erseke, me 28/10/1964, banues ne Shijak, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes n. 082497
- 2- Fatbardh Merko, I biri I Shefqetit, lindur ne Tirane, me 17/05/1969, banues ne Shijak, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes n. 0241377
- 3- Ramazan Ismaili, I biri I Ahmetit, lindur ne Dures, me 17/11/1954, banues ne Shijak, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes n. 1238184
- 4- Gezim Ismaili, I biri I Ahmetit, lindur ne Durres, me 16/06/1952, banues ne Shijak, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes n. 0425656

Te cilet ne pranine time nenshkruan kete statut te shoqerise "MEDIA +" Sha..

Vertetoj keto nenshkrime sipas ligjit.


Gentiana Shkodra
